

“INFINERT+” SHPK

Nipt: M38724101C

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

ID 3.11 “PRODHIMI DHE FRAKSIONIMI I PRODUKTEVE MINERALE JOMETALIKE”

VENDI I USHTRIMIT TE AKTIVITETIT:

**Elbasan Peqin Lagjja nr 1, Rruga Nacionale, objekt privat me
zone kadastrale 3686, me numer pasurie 58/23.**


1. PROFILI I OPERATORIT DHE PROJEKTI

Shoqëria INFINERT+ SHPK, e regjistruar pranë QKB me Nr.NIPT M38724101C, do të pajisjet me leje mjedisi të tipit B për të ushtruar aktivitetin me **ID 3.11 - Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike**.

2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TE AKTIVITETIT

Aktiviteti do të zhvillohet në Elbasan Peqin Lagjja nr 1, Rruga Nacionale, objekt privat me zone kadastrale 3686, me numer pasurie 58/23.

Nr.	X	Y
1.	4400764.68	4545221.98



3. PROCESI TEKNOLOGJIK

Ky proces përfshin zakonisht përpunimin e gurëve gëlqerorë, granitit, rërës, zhavorrit, bentonitit, dolomitit, mermerit etj.

Fazat Kryesore të Procesit Teknologjik:

Thërrmimi dhe Grirja Fillestare

- Materiali i ngurtë futet në impiante thërrmuese (çekiçë, gozhdëza ose çarje çeliku) për t'u reduktuar në përmasa më të vogla.
- Prosesi mund të ketë një ose më shumë faza varësisht nga granulometria e dëshiruar.

Fraksionimi (Ndarja Sipas Përmasave)

- Pasi thërrmohet, materiali kalon në sitë vibruese ose rrotulluese, të cilat ndajnë fraksionet sipas madhësisë.
- Fraksionet zakonisht ndahen në:
 - 0–4 mm (rërë e imët)
 - 4–8 mm
 - 8–16 mm
 - 16–32 mm, etj.
- Ky proces është thelbësor për përgatitjen e materialeve për ndërtim (siç janë agregatet për beton apo asfalt).

Pastrimi dhe Heqja e Papastërtive (Opsionale)



- Në disa raste, përdoret ujë për larjen e materialeve dhe heqjen e pluhurit ose substancave organike.
- Uji i përdorur qarkullon në mënyrë të mbyllur në sisteme recirkulimi.

Ruajtja dhe Paketimi

- Fraksionet e ndara depozitohen në pirgje të ndara në zonën e magazinimit.
- Mund të paketohet në thasë të mëdhenj (big bag), ose të ngarkohet direkt në automjete për shpërndarje.

Pajisjet Kryesore në Proces:

- Ekskavatorë dhe ngarkues frontalë
- Transportues rrëshqitës (konvektorë)
- Thërrmues primar dhe sekondar
- Sita vibruese (vibratore) ose rrotulluese



4. NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS

NDIKIME NË AJËR

Aktiviteti i fraksionimit të inerteve do të shoqërohet me emetime të pluhurit (grimca të ngurta) gjatë fazave të fraksionimit dhe lëvizjes së mjeteve në impiant. Për të reduktuar shkarkimet në ajër, subjekti do të aplikojë lagjen me ujë të rrugëve dhe zonave aktive gjatë periudhave të thata. Këto masa synojnë uljen e përhapjes së pluhurit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonën përreth.

NDIKIME NË TOKË

Ndikimet në mjedisin tokësor lidhen kryesisht me lëvizjen e mjeteve të tonazhit të rëndë për transportin e inerteve. Lëvizja e tyre mund të shkaktojë ngjeshje të tokës dhe degradim të sipërfaqes rrugore. Aktiviteti i fraksionimit do të shoqërohet me rehabilitim progresiv të sipërfaqes së prekur, me materialin e fraksionuar.

NDIKIME NË UJËRA

Përdorimi i ujit do të jetë i kufizuar dhe do të aplikohet vetëm për sprucim me qëllim uljen e pluhurit. Ky ujë do të shpërndahet në mënyrë të kontrolluar dhe nuk do të krijojë rrjedha. Si rezultat, nuk parashikohen shkarkime në ujërat sipërfaqësore, nëntokësore apo në rrjete kanalizimi. Aktiviteti nuk do të gjenerojë ujëra të ndotura teknologjike.

NDIKIME NË KLIMË

Ky aktivitet nuk do të shkaktojë ndryshime të ndjeshme në karakteristikat klimaterike të zonës. Nuk priten ndikime në temperaturë, rryma ajrore, reshje ose lagështi. Zhvillimi i projektit nuk ka ndikim në klimën lokale ose më gjerë.

NDIKIME NGA ZHURMAT

Zhurmat do të gjenerohen kryesisht gjatë operacioneve të fraksionimit dhe transportit të lëndëve të para dhe produktit final. Megjithatë, duke qenë se zona ndodhet larg mjediseve të banuara, nuk pritet të ketë ndotje akustike me ndikim në popullatë. Nivelet e zhurmës do të jenë të kufizuara në perimetrin e zonës së aktivitetit.

Impianti i fraksionimit do të kontrollohet periodikisht për të mbajtur nën kontroll nivelet e zhurmës të gjeneruara prej tij.

NDIKIME NË POPULLËSI

Projekti nuk përfshin lëvizje ose zhvendosje të popullësisë. Aktiviteti nuk përfshin emetime në ajër, ujë apo tokë që mund të ndikojnë në shëndetin e punonjësve ose komunitetit përreth. Subjekti do të ndër marrë masa sigurie dhe do të zbatojë praktika të mira operacionale për mbrojtjen e punonjësve.

NDIKIME NË FLORË DHE FAUNË

Zona ku zhvillohet aktiviteti nuk përmban elementë të veçantë të biodiversitetit. Nuk janë evidentuar specie të mbrojtura ose habitate me rëndësi ekologjike. Rrjedhimisht zhvillimi i aktivitetit nuk përbën ndikim në florë dhe faunë.

TRAJTIMI I MBETJEVE

A. Mbetje të ngurta urbane

Mbetjet e ngurta urbane do të gjenerohen kryesisht nga punonjësit në vendin e punës (mbetje organike, plastike, letër, etj.). Ato do të mblidhen në mënyrë të organizuar dhe do të dërgohen çdo ditë në pikën e grumbullimit të përcaktuar nga Pushteti Vendor. Pushteti vendor do të jetë përgjegjës për trajtimin e mëtejshëm të tyre.

B. Mbetje nga procesi teknologjik

Nga procesi i fraksionimit nuk do të gjenerohen mbetje, pasi materiali inert që nuk arrin të fraksionohet sipas parametrave të kërkuar në ciklin e parë, do të rikthehet në procesin e fraksionimit. Në këtë mënyrë, arrihet përpunimi i plotë dhe shfrytëzimi maksimal i materialit pa krijuar mbetje të tepërta.

Ky qark i mbyllur i përdorimit të materialit siguron efikasitet të lartë teknologjik dhe minimizon ndikimet në mjedis, duke shmangur nevojën për trajtim të mbetjeve të ngurta teknologjike.

"INFINERT+" SHPK

Administrator

Arlind Hasa

Arlind Hasa

